



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 682/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.10.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Ardeno” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-25377-06-05-2019, me objekt: “*Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyresh*”, me fond limit 81.041.227 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara”.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Erald” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit”.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Ardeno” sh.p.k.
Autostrada Tiranë – Durrës, Km 2, Mëzez – Kashar

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë.

Subjekti i interesur:

Operatori ekonomik “Erald” sh.p.k.
Rr. nacionale Tiranë Fushë Krujë, km 13, ndërtesë private 1 katëshe, Zona kadastrale 3096, me nr. Pasurie 97/30, Qerekë, Nikël, Fushë Krujë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 06.06.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-25377-06-05-2019, me objekt: “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyresh”, me fond limit 81.041.227 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 08.07.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (vlera e ofertës, shumatorja e çmimeve për njësi pa TVSH) përkatësisht:

1.	“Erald” sh.p.k.	2.347.620 lekë, kualifikuar
2.	“Ardeno” sh.p.k.	2.648.300 lekë, skualifikuar
3.	“Bolt” sh.p.k.	3.333.535 lekë, skualifikuar
4.	“M. Lezha” sh.p.k.	3.860.180 lekë, kualifikuar
5.	“Erzeni/SH” sh.p.k.	3.899.170 lekë, kualifikuar
6.	“Ro – Al” sh.p.k.	4.006.160 lekë, kualifikuar
7.	“Muça” sh.p.k.	nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
8.	“Buna” sh.p.k.	nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.3. Në datën 18.07.2019 operatori ekonomik “Ardeno” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyet si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik nuk arriti të permbushë piken 2 të Kapacitetit Teknik pasi nuk ka paraqitur Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore leshuar nga administrata tatimore.

II.4. Në datën 22.07.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, ku kundërshton skualifikimin e ofertës së tij si edhe duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “Erald” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon se:

[...]

[...]

Mbi themelin e ankimit

Vendimi për skualifikimin e ofertës tonë është marrë në interpretim të gabuar të dispozitave ligjore dhe në tejkallim të kompetencave të dhëna nga ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në kundërshtim me kriteret kualifikuese të parashikuara në DST të miratuara me VKM nr. 914 datë 29.12.204 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vendimi për kualifikimin dhe skualifikimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi është një akt administrativ në kuptim të nenit 98 të KprAdministrative. Gjithashtu akti administrativ për njoftimin e kriterëve të kualifikimit të operatorit ekonomik është një akt i cili detyrimisht duhet të jetë i sqaruar në kuptim të nenit 100 të KprA pasi ky prek interesa të ligjshëm të palës.

Veprimi i mësipërm përveçse është rezultat i një procesi administrativ të kryer në kundërshtim me dispozitat e KprA nuk respekton gjithashtu asnjë nga elementët e përcaktuara në nenet 98 e vijues të këtij kodi për sa i takon formës së aktit dhe arsyetimit të tij.

Shoqëria “Ardeno” paraqet këtë ankesë duke i konsideruar të pabazuara konstatimin e bërë nga KVO-ja në lidhje me dokumentacionin kualifikues të paraqitur nga ne në tender.

Së pari

Nga ana jonë është bërë deklarimi i listëpagesave sipas afateve të parashikuara në ligj, si dhe pagesa në bankë për detyrimet sipas urdhërpagesës përkatëse që gjenerohet në sitin e tatime.gov.al pas deklarimit të listëpagesës. Pra ne si operatorë/subjekt juridik kemi deklaruar dhe derdhur për llogari të organit përkatës, detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi dhe mandate pagesat për të gjithë periudhën e kërkuar në dokumentat standarte të tenderit që është periudha janar – maj 2019, vërtetuar kjo edeh me formularë të deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të bashkëlidhura me listëpagesat e dorëzuara nga ana jonë për periudhën janar – maj 2019, i cili është i vetmi dokument zyrtar që vërteton pagesën e kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore duke përmbushur kështu kriteret e provueshmërisë së vërtetimit dhe duke përmbushur kriteret për numrin e punonjësve.

Në këtë kuptim referuar dispozitave ligjore të sipërcituara për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike në lidhje me numrin e punonjësve në përpunje dhe në përpjesëtim me natyrën dhe volumin e kontratës objekt prokurimi kapacitet i cili është vërtetuar se disponohet nga operatori ekonomik “Ardeno” shpk. Konkretisht numri mesatar i punonjësve që disponon kjo shoqëri për periudhën janar – maj 2019 e kalon disa herë kërkesën e parashikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, duke krijuar garanci për realizimin me sukses të kontratës.

Sqarojmë se qëllimi i autoritetit kontraktor duhet të jetë verifikimi i kapaciteteve të mjaftueshme për realizimin e kontratës. Përderisa përmbushja e kapaciteteve, në rastin konkret fuqia punëtore, dhe pagesa e kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore provohen me anë të këtyre dokumentave qëllimi final është i realizuar (referuar vendimit të kpp 13/2013).

Gjithashtu referuar edhe praktikës së vendimeve të prokurimit publik dhe konkretisht Vendimi 62/2016 ku është e njëjta arsye skualifikimi si në rastin objekt ankimi ku ndër të tjera citohet se: Përsa i përket argumentit të dytë të autoritetit kontraktor se vërtetimi i lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore është i nevojshëm për autoritetin kontraktor për të vërtetuar se ky operator nuk ka detyrime të papaguara për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se legjislacioni i prokurimit publik, në Dokumentat Standarde të Tenderit, Shtojca 10 “Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit”, pika 2, gërma “b”, e ka parashikuar kriterin lidhur me pagimin e të gjitha detyrimeve të sigurimeve shoqërore ku kërkohet që kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë një dokument që vërteton se (subjekti juaj) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga Administrata Tatimore.

Kriteret e përgjithshme për pranim nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këro kritere duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuara jo më parë se tre muaj nga data e hapjes së ofertës.

Këtë kërkesë ankimuesi e ka plotësuar, duke dorëzuar shkresën me nr. 7641 prot., datë 24.12.2015, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, nëpërmjet të cilës vërtetohet se subjekti “Erges Mat” sh.p.k rezulton se për periudhën deri në datën 30.11.2015 nuk ka detyrime dhe asnjë borxh tatimore për TVSH, tatim mbi fitimin, tatim mbi të ardhurat personale, kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore apo lloje të tjerat tatimesh.

Duke qënë se procedura e mësipërme e prokurimit është zhvilluar në datën 12.01.2016, ky dokument është i rregullt dhe garanton autoritetin kontraktor për seriozitetin dhe besueshmërinë e shoqërisë “Erges Mat” sh.p.k lidhur me pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe detyrimeve të tjera të parashikuara në kriteret e përgjithshme të kualifikimit.

Pretendimi i operatorit ekonomik “Erges Mat” sh.p.k qëndron.

Referuar arsyetimit të vendimit të KPP përsa kohë që shoqëria ankimuese “Ardeno” sh.p.k. ka dorëzuar shkresën me nr. T01172541, datë 20.06.2019 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet të cilës vërtetohet se subjekti Ardeno shpk rezulton se për periudhën deri në datën 20.06.2019 nuk ka detyrime dhe asnjë borxh tatimor për TVSH, tatim mbi fitimin, tatim mbi të ardhurat personale, kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore apo lloje të tjerat tatimesh. Duke qënë se procedura e mësipërme e prokurimit është zhvilluar në datën 08.07.2019, ky dokument është i rregullt dhe garanton autoritetin kontraktor për seriozitetin dhe besueshmërinë e shoqërisë “Ardeno” sh.p.k. lidhur me pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe detyrimeve të tjera të parashikuara në kriteret e përgjithshme të kualifikimit.

Së dyti,

Referuar nenit 53 pika 3 të LPP parashikohet se: [...].

Në VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë: [...].

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike në lidhje me fuqinë punëtore në përputhje dhe në përpjesëtim me natyrën dhe volumin e kontratës objekt prokurimi kapacitet i cili është vërtetuar se disponohet nga operatori ankimues.

Përsa më sipër për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet e duhura për kontratën dhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale kapacitetet e dokumentuara nga ofertuesit në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara.

Së treti

Ne vlerësojmë se operatori “Ardeno” sh.p.k. disponon të gjitha kapacitetet kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, organizative, makineritë, pajisje e asetet të cilat përmbushin kërkesat në raport me natyrën e punimeve dhe elementët konkretë të realizimit të zërave të preventivit që autoriteti kontraktor synon të arrijë në këtë procedurë prokurimi.

Pretendimet e skualifikimit të KVO bie në kundërshtim me qëllimin e ligjit të përcaktuara në nenin 1 të tij, duke frenuar konkurrencën dhe duke bërë një trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Sa më sipër analizuar vlerësojmë se operatori ankimes “Ardeno” sh.p.k. i ka përmbushur kriteret e kualifikimit duke vërtetuar se disponon kapacitetet ligjore, financiare dhe teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për të realizuar këtë kontratë, prandaj justifikimi i KVO nuk mund të jetë argument që anashkallon ofertën tonë ekonomike me vlerë 2.648.300 lekë për njësi e cila rezultoi me cmimin më të ulët se ofertat pjesëmarrëse të kualifikuara.

II. Gjithashtu KVO ka shpallur fitues për këtë procedurë prokurimi operatorin ekonomik Erald shpk.

Në lidhje me kualifikimin e ofertës së këtij operatori ekonomik kundërshtojmë kualifikimin e këtij operatori me argumentat tona si më poshtë:

1- Operatori ekonomik ka paraqitur ofertë anomalisht të ulët dhe me të drejtë KVO ka kërkuar sqarim oferte. Nga të dhënat e siguruara në Sistemin e Prokurimit Publik në kthimin e përgjigjes për argumentim të ofertës (dokumentat e printuara janë marrë në dritaren kërkesat të faqes së APP-së të kësaj procedure) shikojmë në këndvështrimin tonë duke qenë se ne e njohim shumë mirë që në detaj ciklin e prodhimit për produktet e ofertuara, argumentimi nëpërmjet dokumentacionit të ofruar nga ky operator e bën të pavlefshëm kualifikimin e ofertës së tij pasi në elementët e ofertës të ofruara nga operator ekonomik rezulojnë në kundërshtim me ligjin.

KVO në vlerësimin e saj duhet të ishte referuar nenit 56 të LPP (oferta anomalisht e ulët) ku cilësohet:[...]

Operatori ekonomik Erald shpk në kthimin e përgjigjes për të argumentuar analizën e kostos së ofertës për këtë procedurë prokurimi rezulton se ka disa shkelje të ligjit sipas dokumentacionit të dorëzuar nga vetë Operatori ekonomik në sistem dhe konkretisht:

Për ofertën ekonomike të ofruar nuk ka argumentuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit, origjinalitetin e punëve, mallrave apo shërbimeve të propozuara nga ofertuesi: për një sasi të konsiderueshme të produkteve të ofertuara nga ky OE . Më konkretisht:

1- Për banak reception nuk kemi fatura origjinë të lëndës së parë për Melaminë 25mm, melaminë 18mm, mentesha, trekëndësja montues, tapa fundore, vida, tenije etj.

2- Mungon totalisht sqarimi i ofertës për produktet Dollap metalik me dyer, dollap metalik me sirtar, poltron rrotullues, raft metalik për arkivë, raft metalik për dosje, varëse rrobash dhe mbajtëse çadrash, varëse rrobash metalike, rafte metalik, poltrona rrotullues, varëse rrobash metalik (kokë prifti), varëse rrobash plastike, komplet perdes, perde roller screen, karrige auditori, karrige për tavolinën e mbledhjeve, karrige për drejtorët, karrige për mbledhjet, grila për dritaret. Nuk kemi të dhëna për koston e prodhimit nga ana e OE ose fatura blerje të produktit të gatshëm.

3- Për dollap për dosje dy kanatësh nuk kemi fatura origjine të lëndës së parë për: Melaminë 25mm, melaminë 18mm, fibër, brava, doreza, thumba, zumpare, shula, mentesha, trekëndësha montues, tapa fundore, vida, tenije, etj.

4- Për dollap për zyra dy kanatësh nuk kemi fatura origjine të lëndës së parë për: Melaminë 25mm, melaminë 18mm, fibër, brava, doreza, thumba, zumpare, shula, mentesha, trekëndësha montues, tapa fundore, vida, tenije, etj.

5- Për dollap për zyra një kanatësh nuk kemi fatura origjine të lëndës së parë për: Melaminë 25mm, melaminë 18mm, fibër, brava, doreza, thumba, zumpare, shula, mentesha, trekëndësha montues, tapa fundore, vida, tenije, etj.

6- Për Etazher për zyrë e veçantë nuk kemi fatura origjine të lëndës së parë për: Melaminë 25mm, melaminë 18mm, fibër, brava, doreza, thumba, zumpare, shula, mentesha, trekëndësha montues, tapa fundore, vida, tenije 28mm, tenije 22mm, xham 04cm etj.

7- Mungon totalisht sqarimi i ofertës për produktet: Karrige për salla konferencash, për karrige rrotulluese me krahë mbështetës metalik, karrige tip kinema, kasaforta.

Nuk kemi të dhëna për koston e prodhimit nga ana e OE ose faturë blerje të produktit të gatshëm.

8- Për komplet kolltuqesh fatura e origjinës për: dërrasën, pllak grexo, fibër, sfungjer, vatinë, zinxhir.

9- Për krevat tek nuk kemi fatura origjine të lëndës së parë për: Melaminë 25mm, melaminë 18mm, mentesha, trekëndësha montues, tapa fundore, vida, tenije etj.

10- Për poltron pritje dy vendesh dhe një vendësh mungon fatura e origjinës për: dërrasën, pllak grexo, fibër, sfungjer, vatinë, zinxhir.

11- Për artikullin (Tavolinë mesi) zërat e produkteve në analizën e koston nuk përputhen me specifikimet e produktit të hedhur në sistem.

12- Për artikujt raft për dosje, sirtaret e lëvizshme me rrota, etazher për zyrë e veçantë nuk kemi fatura origjine të lëndës së parë për: Melaminë 25mm, melaminë 18mm, fibër, brava, doreza, thumba, zumpare, shula, mentesha, trekëndësha montues, tapa fundore, vida, tenije, etj.

13- Për artikujt Tavolinë e madhe mbledhjesh, tavolinë e vecantë për sallë mbledhjesh, tavolinë e vogël mbledhjesh, tavolinë kompjuteri, tavolinë pune, tavolinë pune e thjeshtë në formë L, tavolinë pune rang drejtuesi, foltore, tavolinë televizori, tavolinë ovale mbledhjesh, tavolinë për drejtorët nuk kemi fatura origjine të lëndës së parë për: Melaminë 25mm, melaminë 18mm, doreza, thumba, zumpare, mentesha, trekëndësha montues, tapa fundore, vida, tenije plastike e trashësisë së ndryshme etj.

Si përfundim gati 95% e produkteve të ofertuara nga OE nuk kanë analizë kostoje të argumentuar apo fatura blerje të produktit të gatshëm për të cilat arrihej në një gjykim për ofertën e dhënë, si pasojë oferta e këtij operatori ekonomik është e pasuksesshme.

- Pezullimin e vazhdimit të procedurës së prokurimit derisa ankesa jonë të jetë shqyrtuar plotësisht
- Rivlerësimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik Ardeno shpk kualifikimin e saj
- Skualifikimin e operatorit ekonomik "Erald" sh.p.k.
- Shpalljen fitues të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik Ardeno shpk.

II.5. Operatori ekonomik ankimues pretendon se në datën 30.07.2019 është njohur me shkresën nr. 1325/2 prot., datë 26.07.2019.12.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar ankesën.

II.6. Në datën 02.08.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar skualifikimin e tij si edhe duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “Erald” sh.p.k.

Konkretisht në ankesën e paraqitur pranë KPP-së operatori ekonomik ankimues argumenton:

[...]

Mbi themelin e ankimit

Vendimi për skualifikimin e ofertës tonë është marrë në interpretim të gabuar të dispozitave ligjore dhe në tejkalim të kompetencave të dhëna nga ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në kundërshtim me kriteret kualifikuese të parashikuara në DST të miratuara me VKM nr. 914 datë 29.12.2004 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vendimi për kualifikimin dhe skualifikimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi është një akt administrativ në kuptim të nenit 98 të KprAdministrative. Gjithashtu akti administrativ për njoftimin e kriterëve të kualifikimit të operatorit ekonomik është një akt i cili detyrimisht duhet të jetë i sqaruar në kuptim të nenit 100 të KprA pasi ky prek interesa të ligjshëm të palës.

Veprimi i mësipërm përveçse është rezultat i një procesi administrativ të kryer në kundërshtim me dispozitat e KprA nuk respekton gjithashtu asnjë nga elementët e përcaktuara në nenet 98 e vijues të këtij kodi për sa i takon formës së aktit dhe arsyetimit të tij.

Shoqëria “Ardeno” paraqet këtë ankesë duke i konsideruar të pabazuara konstatimin e bërë nga KVO-ja në lidhje me dokumentacionin kualifikues të paraqitur nga ne në tender.

Së pari

Nga ana jonë është bërë deklarami i listëpagesave sipas afateve të parashikuara në ligj, si dhe pagesa në bankë për detyrimet sipas urdhërpagesës përkatëse që gjenerohet në sitin e tatime.gov.al pas deklarimit të listëpagesës. Pra ne si operatorë/subjekt juridik kemi deklaruar dhe derdhur për llogari të organit përkatës, detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi dhe mandate pagesat për të gjithë periudhën e kërkuar në dokumentat standarte të tenderit që është periudha janar – maj 2019, vërtetuar kjo edeh me formularë të deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të bashkëlidhura me listëpagesat e dorëzuara nga ana jonë për periudhën janar – maj 2019, i cili është i vetmi dokument zyrtar që vërteton pagesën e kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore duke përmbushur kështu kriteret e provueshmërisë së vërtetimit dhe duke përmbushur kriteret për numrin e punonjësve.

Në këtë kuptim referuar dispozitave ligjore të sipërcituara për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike në lidhje me numrin e punonjësve në përputhje dhe në përpjesëtim me natyrën dhe volumin e kontratës objekt prokurimi kapacitet i cili është vërtetuar se disponohet nga operatori ekonomik “Ardeno” shpk.

Konkretisht numri mesatar i punonjësve që disponon kjo shoqëri për periudhën janar – maj 2019 e kalon disa herë kërkesën e parashikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, duke krijuar garanci për realizimin me sukses të kontratës.

Sqarojmë se qëllimi i autoritetit kontraktor duhet të jetë verifikimi i kapaciteteve të mjaftueshme për realizimin e kontratës. Përderisa përmbushja e kapaciteteve, në rastin konkret fuqia punëtore, dhe pagesa e kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore provohen me anë të këtyre dokumentave qëllimi final është i realizuar (referuar vendimit të kpp 13/2013).

Gjithashtu referuar edhe praktikës së vendimeve të prokurimit publik dhe konkretisht Vendimi 62/2016 ku është e njëjta arsye skualifikimi si në rastin objekt ankimi ku ndër të tjera citohet se: Përsa i përket argumentit të dytë të autoritetit kontraktor se vërtetimi i lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore është i nevojshëm për autoritetin kontraktor për të vërtetuar se ky operator nuk ka detyrime të papaguara për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se legjislacioni i prokurimit publik, në Dokumentat Standarde të Tenderit, Shtojca 10 “Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit”, pika 2, gërma “b”, e ka parashikuar kriterin lidhur me pagimin e të gjitha detyrimeve të sigurimeve shoqërore ku kërkohet që kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë një dokument që vërteton se (subjekti juaj) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga Administrata Tatimore. Kriteret e përgjithshme për pranim nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këro kritere duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuara jo më parë se tre muaj nga data e hapjes së ofertës.

Këtë kërkesë ankimesi e ka plotësuar, duke dorëzuar shkresën me nr. 7641 prot., datë 24.12.2015, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, nëpërmjet të cilës vërtetohet se subjekti “Erges Mat” sh.p.k rezulton se për periudhën deri në datën 30.11.2015 nuk ka detyrime dhe asnjë borxh tatimore për TVSH, tatim mbi fitimin, tatim mbi të ardhurat personale, kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore apo lloje të tjerat tatimesh.

Duke qënë se procedura e mësipërme e prokurimit është zhvilluar në datën 12.01.2016, ky dokument është i rregullt dhe garanton autoritetin kontraktor për seriozitetin dhe besueshmërinë e shoqërisë “Erges Mat” sh.p.k lidhur me pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe detyrimeve të tjera të parashikuara në kriteret e përgjithshme të kualifikimit.

Pretendimi i operatorit ekonomik “Erges Mat” sh.p.k qëndron.

Referuar arsyetimit të vendimit të KPP përsa kohë që shoqëria ankimese “Ardeno” sh.p.k. ka dorëzuar shkresën me nr. T01172541, datë 20.06.2019 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet të cilës vërtetohet se subjekti Ardeno shpk rezulton se për periudhën deri në datën 20.06.2019 nuk ka detyrime dhe asnjë borxh tatimor për TVSH, tatim mbi fitimin, tatim mbi të ardhurat personale, kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore apo lloje të tjerat tatimesh. Duke qënë se procedura e mësipërme e prokurimit është zhvilluar në datën 08.07.2019, ky dokument është i rregullt dhe garanton autoritetin kontraktor për seriozitetin dhe besueshmërinë e shoqërisë “Ardeno” sh.p.k. lidhur me pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe detyrimeve të tjera të parashikuara në kriteret e përgjithshme të kualifikimit.

Së dyti,

Referuar nenit 53 pika 3 të LPP parashikohet se: [...].

Në VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë: [...].

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike në lidhje me fuqinë punëtore në përputhje dhe në përpjesëtim me natyrën dhe volumin e kontratës objekt prokurimi kapacitet i cili është vërtetuar se disponohet nga operatori ankimues.

Përsa më sipër për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet e duhura për kontratën dhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale kapacitetet e dokumentuara nga ofertuesit në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara.

Së treti

Ne vlerësojmë se operatori “Ardeno” sh.p.k. disponon të gjitha kapacitetet kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, organizative, makineritë, pajisje e asetet të cilat përmbushin kërkesat në raport me natyrën e punimeve dhe elementët konkretë të realizimit të zërave të preventivit që autoriteti kontraktor synon të arrijë në këtë procedurë prokurimi.

Pretendimet e skualifikimit të KVO bie në kundërshtim me qëllimin e ligjit të përcaktuara në nenin 1 të tij, duke frenuar konkurrencën dhe duke bërë një trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Sa më sipër analizuar vlerësojmë se operatori ankimues “Ardeno” sh.p.k. i ka përmbushur kriteret e kualifikimit duke vërtetuar se disponon kapacitetet ligjore, financiare dhe teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për të realizuar këtë kontratë, prandaj justifikimi i KVO nuk mund të jetë argument që anashkalon ofertën tonë ekonomike me vlerë 2.648.300 lekë për njësi e cila rezultoi me cmimin më të ulët se ofertat pjesëmarrëse të kualifikuara.

II. Gjithashtu KVO ka shpallur fitues për këtë procedurë prokurimi operatorin ekonomik Erald shpk.

Në lidhje me kualifikimin e ofertës së këtij operatori ekonomik kundërshtojmë kualifikimin e këtij operatori me argumentat tona si më poshtë:

- 1- Operatori ekonomik ka paraqitur ofertë anomalisht të ulët dhe me të drejtë KVO ka kërkuar sqarim oferte.*

Nga të dhënat e siguruara në Sistemin e Prokurimit Publik në kthimin e përgjigjes për argumentim të ofertës (dokumentat e printuara janë marrë në dritaren kërkesat të faqes së APP-së të kësaj procedure) duke qenë se ne e njohim shumë mirë që në detaj ciklin e prodhimit për produktet e ofertuara, argumentimi nëpërmjet dokumentacionit të ofruar nga ky operator e bën të pavlefshëm kualifikimin e ofertës së tij pasi në elementët e ofertës të ofruara nga operator ekonomik rezulojnë në kundërshtim me ligjin.

KVO në vlerësimin e saj duhet të ishte referuar nenit 56 të LPP (oferta anomalisht e ulët) ku cilësohet:

[...]

Operatori ekonomik Erald shpk në kthimin e përgjigjes për të argumentuar analizën e kostos së ofertës për këtë procedurë prokurimi rezulton se ka disa shkelje të ligjit sipas dokumentacionit të dorëzuar nga vetë Operatori ekonomik në sistem dhe konkretisht:

Për ofertën ekonomike të ofruar nuk ka argumentuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit, origjinalitetin e punëve, mallrave apo shërbimeve të propozuara nga ofertuesi: për një sasi të konsiderueshme të produkteve të ofertuara nga ky OE . Më konkretisht:

1- Për banak reception nuk kemi fatura origjinë të lëndës së parë për Melaminë 25mm, melaminë 18mm, mentesha, trekëndësha montues, tapa fundore, vida, tenije etj.

2- Mungon totalisht sqarimi i ofertës për produktet Dollap metalik me dyer, dollap metali me sirtar, poltron rrotullues, raft metalik për arkivë, raft metalik për dosje, varëse rrobash dhe mbajtëse çadrash, varëse rrobash metalike, rafte metalik, poltrona rrotullues, varëse rrobash metalik (kokë prifti), varëse rrobash plastike, komplet perdes, perde roller screen, karrige auditori, karrige për tavolinën e mbledhjeve, karrige për drejtorët, karrige për mbledhjet, grila për dritaret. Nuk kemi të dhëna për koston e prodhimit nga ana e OE ose fatura blerje të produktit të gatshëm.

3- Për dollap për dosje dy kanatësh nuk kemi fatura origjine të lëndës së parë për: Melaminë 25mm, melaminë 18mm, fibër, brava, doreza, thumba, zumpare, shula, mentesha, trekëndësha montues, tapa fundore, vida, tenije, etj.

4- Për dollap për zyra dy kanatësh nuk kemi fatura origjine të lëndës së parë për: Melaminë 25mm, melaminë 18mm, fibër, brava, doreza, thumba, zumpare, shula, mentesha, trekëndësha montues, tapa fundore, vida, tenije, etj.

5- Për dollap për zyra një kanatësh nuk kemi fatura origjine të lëndës së parë për: Melaminë 25mm, melaminë 18mm, fibër, brava, doreza, thumba, zumpare, shula, mentesha, trekëndësha montues, tapa fundore, vida, tenije, etj.

6- Për Etazher për zyrë e veçantë nuk kemi fatura origjine të lëndës së parë për: Melaminë 25mm, melaminë 18mm, fibër, brava, doreza, thumba, zumpare, shula, mentesha, trekëndësha montues, tapa fundore, vida, tenije 28mm, tenije 22mm, xham 04cm etj.

7- Mungon totalisht sqarimi i ofertës për produktet: Karrige për salla konferencash, për karrige rrotulluese me krahë mbështetës metalik, karrige tip kinema, kasaforta.

Nuk kemi të dhëna për koston e prodhimit nga ana e OE ose faturë blerje të produktit të gatshëm.

8- Për komplet kolltuqesh fatura e origjinës për: dërrasën, pllak grexo, fibër, sfungjer, vatinë, zinxhir.

9- Për krevat tek nuk kemi fatura origjine të lëndës së parë për: Melaminë 25mm, melaminë 18mm, mentesha, trekëndësja montues, tapa fundore, vida, tenije etj.

10- Për poltron pritje dy vendesh dhe një vendësh mungon fatura e origjinës për: dërrasën, pllak grexo, fibër, sfungjer, vatinë, zinxhir.

11- Për artikullin (Tavolinë mesi) zërat e produkteve në analizën e kostos nuk përputhen me specifikimet e produktit të hedhur në sistem.

12- Për artikujt raft për dosje, sirtaret e lëvizshme me rrota, etazher për zyrë e veçantë nuk kemi fatura origjine të lëndës së parë për: Melaminë 25mm, melaminë 18mm, fibër, brava, doreza, thumba, zumpare, shula, mentesha, trekëndësja montues, tapa fundore, vida, tenije, etj.

13- Për artikujt Tavolinë e madhe mbledhjesh, tavolinë e vecantë për sallë mbledhjesh, tavolinë e vogël mbledhjesh, tavolinë kompjuteri, tavolinë pune, tavolinë pune e thjeshtë në formë L, tavolinë pune rang drejtuesi, foltore, tavolinë televizori, tavolinë ovale mbledhjesh, tavolinë për drejtorët nuk kemi fatura origjine të lëndës së parë për: Melaminë 25mm, melaminë 18mm, doreza, thumba, zumpare, mentesha, trekëndësja montues, tapa fundore, vida, tenije plastike e trashësisë së ndryshme etj.

Si përfundim gati 95% e produkteve të ofertuara nga OE nuk kanë analizë kostoje të argumentuar apo fatura blerje të produktit të gatshëm për të cilat arrihej në një gjykim për ofertën e dhënë, si pasojë oferta e këtij operatori ekonomik është e pasuksesshme.

Me shkresën me nr. 1325/2 prot, e datës 26.07.2019 me objekt “Vendim kthim përgjigje të ankesës sonë (bashkëlidhur kësaj ankese). Ankesë e cila nuk pranohet nga autoriteti kontraktor me arsyet që do të japin më poshtë:

1. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik konstatohet se nga ana e ofertusit “Ardeno” sh.p.k. në përmbushje të kriterit sa më sipër është dorëzuar dokumentacioni me emërtim “Vërtetim për pagim detyrimesh”, nr. T01172541 prot., datë 20.06.2019 i cili rezulton të jetë jo në përputhje me kërkesën e vendosur në pikën 2 të kapacitetit teknik – Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore – që lidhet me vërtetimin e pasjes së një numri punonjësish prej minimalisht 30 të punësuar. Referuar nenit 53, pika 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” , i ndryshuar, përcaktohet se: [...].

Gjithashtu nëse operatori ankimes do të kishte paqartësi në dokumentat e tenderit mund të kishte kërkuar sqarim ose mund të bënte ankesë brenda 7 ditëve nga publikimi i procedurës.

2. Përsa i përket pretendimit të dytë të operatorit ankimes për kualifikimin e padrejtë të operatorit “Erald” sh.p.k. në sistemin e prokurimit elektronik sqaron se ka dhënë argumentat e paraqitjes së ofertës anomalisht të ulët bazuar në ligj. Në vlerësimin e argumentave të të dhënave, nuk konstatohen parregullsi teknike dhe procedurale. Shoqëria “Erald” sh.p.k. ka shpjeguar elementët e veçantë të ofertës ekonomike dhe konkretisht:

a) Anën ekonomike të procesit të prodhimit ose shërbimeve të ofruara (për artikujt e ofertuar ka mundësi maksimale edhe për një organizim të përsosur të punës, pasi bën një ndarje në mes të reparteve të punës (prerjes – montimit – ilustrimit); larmia e produkteve të ndryshme mundëson një shfrytëzim në maksimum të lëndëve të para, pasi dhe prodhimi fillon nga objektet me përmasa të mëdha, duke vazhduar tek objektet me përmasa të vogla).

b) zgjidhje teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve (teknologjia e përdorur në prodhimin e mobiljeve është

një teknologji e përparuar dhe e avancuar, ambientet në të cilat shoqëria ushtron aktivitetin prodhues, janë ambiente të ndriçuara mirë, duke lejuar shfrytëzimin maksimal, të dritës natyrale, gjë e cila ndikon në rendimentin e punës të punëtorëve).

c) Origjinalitetin e mallrave apo të shërbimeve të propozuara (firma ka siguruar lëndën e parë nëpërmjet importimit si dhe tregjeve të ndryshme në Shqipëri me çmimet konkurruese) është e çertifikuar nga organizma ndërkombëtarë lidhur me cilësinë e produkteve që ajo ofron në treg si dhe produktet që kjo shoqëri ofron janë konform të gjitha standarteve e komunitetit europian përsa i përket cilësisë.

d) Zbatueshmëria e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës në vendin ku kryhet shërbimi apo ku sigurohet furnizimi (zona gjeografike në të cilën është pozicionuar shoqëria, krijojnë kushte lehtësuese për gjetjen e punonjësve, ka një eksperiencë prej 22 vitesh në treg dhe një staf të përbërë prej 54 personash).

Duke qenë se oferta ekonomike e paraqitur nga ofertues “Erald” sh.p.k. ka argumentuar për të gjitha elementët e veçantë të anës ekonomike të mallrave të ofruara, zgjidhjes teknike, origjinalitetin e mallrave dhe zbatueshmërinë e detyrimeve, në përputhje me ligjin, krijohet bindja se oferta e paraqitur është konform parashikimeve ligjore me të gjitha elementët e saj dhe pranohet si e rregullt.

Për arsyet e mësipërme pretendimi i ofertuesit “Ardeno” sh.p.k. nuk pranohet.

Duke mos qenë dakord me vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave pranë autoritetit kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara po i drejtohem KPP me ankesën administrative si organi më i lartë në fushën e prokurimit publik jo vetëm me të njëjtat argumenta e mësipërme që jemi ankuar në autoritetin kontraktor por duke shtuar edhe disa argumenta të tjerë.

- *Përsa i përket argumentit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të pretendimit të parë jo vetëm nuk qëndron por në mendimin tonë është në interpretim të gabuar të ligjit sepse:*

Sigurisht që operatori ekonomik ka pasur mundësinë që nëse do të kishte paqartësi në dokumentat e tenderit mund të kishte kërkuar sqarim ose mund të bënte ankesë brenda 7 ditëve nga publikimi i procedurës por kjo nuk justifikon lajthitjen e autoritetit kontraktor në vendosjen e kriterëve për kualifikim sepse:

Referuar të gjithë praktikës së KPP në të gjitha vendimet është cituar se:

Autoritetet kontraktore nuk mund të vendosin kriterë të cilat janë në kundërshtim të nenit 1 dhe 2, dhe 46 të ligjit 9643....., dhe janë në kapërcim të kushteve dhe kriterëve që përcaktohen në ligjet apo Kodet në Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 46, pika 1 gërma “c” e ligjit 9643 parashikohet se: [...].

Kjo do të thotë se pavarësisht operatorët ekonomikë e kanë të drejtë të ankohen për ndryshim kriteresh referuar nenit 63 pika 1/1 e ligjit 9643 të lpp, në rastin e ankesave për dokumentat e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen tek AK brenda 7 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës në faqen e internetit në faqen zyrtare të APP-së kjo nuk do të thotë se një kriter i paligjshëm dhe diskriminues bëhet i ligjshëm përsa kohë nuk ka ankesë nga operatorët ekonomikë referuar nenit 63 pika 1/1 e ligjit 9643 të LPP, është kjo arsyeja që ligji nr. 9643 i

LPP i ka njohur të drejtën e ankimit administrativ tek Komisioni i Prokurimit Publik si organi më i lartë në shqyrtimin e ankesave administrative në fushën e prokurimit publik.

Por ti referohemi të gjitha praktikave e të gjitha autoriteteve kontraktore në plotësimin e dokumentave standarte do të kuptojmë se pika 2 e dst të plotësuara nga autoriteti kontraktor ështëënë kundërshtim të nenit 1 dhe 2 dhe 46 të LPP dhe janë në kapërcim të kushteve dhe kritereve që përcaktohen në ligjet apo kodet në Republikën e Shqipërisë sepse:

Pika 2: Operatori ekonomik pjesëmarrës në rast se është prodhues i mobiljeve të drurit duhet të ketë të punësuar për periudhën janar –maj 2019 një staf punonjësish minimalisht 40 persona nga të cilët të paktën 1 punonjës duhet të jetë i punësuar si inxhinier druri i pajisur me diplomë dhe kontratë pune e vlefshme i përfshirë në listëpagesa. Për stafin e punonjësve ofertuesi duhet të paraqesë:

- *Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore.*
- *Listëpagesa për periudhën janar – maj 2019*

Kur në fakt duhet të ishte plotësuar si më poshtë:

- *Vërtetim të lëshuar nga Administrata tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën janar – maj 2019*
- *Listëpagesa për periudhën janar-maj 2019*

Pra argumentimi që komisioni i shqyrtimit të ankesave se vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore – që lidhet me vërtetimin e pasjes së një numri punonjësish prej minimalisht 30 të punësuar.

Nuk qëndron sepse: vërtetimi i pasjes së një numri punonjësish prej minimalisht 30 të punësuar nuk ka lidhje me vërtetimin për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore sepse janë 2 dokumenta të ndryshme dhe nëse autoriteti kontraktor ka pasur për qëllim vendosjen e këtij kriteri për vërtetimin e një numri punonjësish prej minimalisht 30 duhet ta vendoste kriterin “Vërtetim të lëshuar nga Administrata tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën janar –maj 2019” dhe jo “Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore”.

Pra edhe nga argumentimi i komisionit të shqyrtimit të ankesave kuptohet qartë lajthitja e autoritetit kontraktor në vendosjen e këtij kriteri të paqartë.

Pavarësisht të gjitha argumentave tona të mësipërm operatori ankimues e ka plotësuar këtë kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor me dorëzimin në faqen zyrtare të APP dokumentacioni me emërtim “Vërtetim për pagim detyrimesh nr. T01172541 prot., datë 20.06.2019 i cili është dokument zyrtar i lëshuar nga organi administrativ i ngarkuar me ligj për lëshimin dhe për vërtetimin e kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor, gjithashtu autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë 2 dokumenta për të vërtetuar të njëjtën gjë.

- *Përsa i përket argumentimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të pretendimit të dytë jo vetëm nuk qëndron por në mendimin tonë është në interpretim të gabuar të ligjit sepse:*

Referuar nenit 56 të lpp parashikon se [...].

Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të lpp konstatohet se barra e provës mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014.

Argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesin e prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe / ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetin kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si dhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. Katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat me anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP autoriteti kontraktor i verifikon këto elementë duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementët e saj. Gjykojme se nga interpretimi i normës së mësipërme, qëllimi i saj lidhet drejtëpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofërë e cila rezulton anomalisht e ulët. Risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur, rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara, humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu referuar nenit 1 gërma b, e lpp parashikohet se[...]. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta e cilësuar si anomalisht të ulëta referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj.

Përsa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Erald” sh.p.k. dhe nga argumentimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave ku shpjegon elementët e veçantë të ofertës ekonomike të paraqitur nga operatori “Erald” sh.p.k. në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit rezulton se mendimin tonë nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Operatori "Erald" sh.p.k. nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës ose provues si: fatura tatimore, fletë zhdoganimi, kontrata furnizimi, kontrata të mëparshme të lidhura me autoritete të ndryshme apo ndonjë dokument tjetër që të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Përveç argumentimit të vet në formën e një preventivi vetdeklarativ, nuk ka paraqitur prova shkresore për elementët e ofertës sikurse kërkuar. Operatori ekonomik ka detyrimin ligjor që të prezantojë me dokumentacion provues zgjidhjet teknike dhe / ose ndonjë kushte favorizues që do të garantonin realizimin e punimeve pranë autoritetit kontraktor. Paraqitja e zërit të preventivit i pashoqëruar me dokumentacionin shtesë provues nuk mund të konsiderohet si provë pasi në vetvete nuk provon dhe garanton ofertën ekonomike si dhe realizimin e punimeve. Gjithashtu nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur dhe argumentuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nga ana e ofertuesit nuk rezulton të jenë parashtruar të dhëna, fakte apo garanci për origjinalitetin e punimeve në referim të gërmës "c" neni 56 pika 2 të LPP pasi provueshmëria e këtij kriteri është esenciale duke garantuar autoritetin kontraktor jo vetëm për realizimin e punimeve por për realizimin e tyre sipas standarteve të kërkuara në cilësi dhe volum dhe me çmimin konkurrues të ofertuar. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, shoqëria ankimese gjykon se nga ana e operatorit ekonomik "Erald" sh.p.k. oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i plotë që të argumentojë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar) duke mos na krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Së dyti,

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave referuar shkresës me nr. 1325/2 prot., e datë 26.07.2019 me objekt "Vendim, kthim përgjigje të ankesës sonë, na sqaroj se: me shkresën kthim përgjigje depozituar nga ofertuesi "Erald" sh.p.k. në sistemin e prokurimeve elektronike ka dhënë argumentat e paraqitjes së ofertës anomalisht të ulët bazuar në ligj. Në vlerësimin e argumentave të të dhënave nuk konstatohen parregullsi teknike dhe procedurale. Shoqëria "Erald" sh.p.k. ka shpjeguar elementët e veçantë të ofertës ekonomike.

Në gjykimin tonë shpjegimet e dhëna për elementët e veçantë të ofertës ekonomike të operatorit "Erald" sh.p.k. jo vetëm nuk janë të bazuara në nenit 56 të lpp, por në gjykimin tonë Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk ka kuptuar qartë plotësimin e 4 kushteve kumulative që duhet të plotësohen nga operatori ekonomik "Erald" sh.p.k.

Referuar pikës a) Anën ekonomike të procesit të prodhimit ose shërbimeve të ofruara (për artikujt e ofertuar ka mundësi maksimale edhe për një organizim të përsosur të punës, pasi bën një ndarje në mes të reparteve të punës (prerjes – montimit – ilustrimit); larmia e produkteve të ndryshme mundëson një shfrytëzim në maksimum të lëndëve të para, pasi dhe prodhimi fillon nga objektet me përmasa të mëdha, duke vazhduar tek objektet me përmasa të vogla).

Argumentimi i mësipërme nuk qëndron sepse: ana ekonomike duhet të spari të vërtetohet me dokumenta provues dhe jo vetëm me shpjegime të pa provuara dhe me argumenta që skanë lidhje

anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, ndarja e reparteve të punës apo larmia e produkteve nuk përbën ndonjë kusht favorizues të anës ekonomike në favor me operatorët e tjerë konkurues në këtë procedurë tenderimi.

Referuar pikës b) zgjidhje teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve (teknologjia e përdorur në prodhimin e mobiljeve është një teknologji e përparuar dhe e avancuar, ambientet në të cilat shoqëria ushtron aktivitetin prodhues, janë ambiente të ndriçuara mirë, duke lejuar shfrytëzimin maksimal, të dritës natyrale, gjë e cila ndikon në rendimentin e punës të punëtorëve).

Argumentimi i mësipërm nuk qëndron sepse argumenti se teknologjia e përdorur në prodhimin e mobiljeve është një teknologji e përparuar dhe e avancuar por pa dhënë asnjë prove dhe dokument provues se për çfarë teknologjie të avancuar bëhet fjalë, teknologji e cila i jep prioritet shoqërisë Erald shpk në krahasim me ofertuesit e tjerë duke ofruar produkte me çmime të lira.

Pra duhet të argumentonte dhe provonte me dokumenta shoqërues se për shkak të teknologjisë së përdoruar nga shoqëria Erald shpk kosto për materialet e prodhuara janë më të lira se tregu, gjë për të cilën nuk ka mundur të argumentojë. Kurse argumenti i dytë se “ambientet në të cilat shoqëria ushtron aktivitetin prodhues, janë ambiente të ndriçuara mirë, duke lejuar shfrytëzim maksimal të dritës natyrale, e cila ndikon në rendimentin e punës së punëtorëve”, është një argument që nuk po i japim përgjigje.

Referuar pikës c) Origjinalitetin e mallrave apo të shërbimeve të propozuara (firma ka siguruar lëndën e parë nëpërmjet importimit si dhe tregjeve të ndryshme në Shqipëri me çmimet konkurruese) është e certifikuar nga organizma ndërkombëtarë lidhur me cilësinë e produkteve që ajo ofron në treg si dhe produktet që kjo shoqëri ofron janë konform të gjitha standarteve e komunitetit europian përsa i përket cilësisë.

Argumentimi i mësipërm nuk qëndron sepse nga ana e ofertuesit nuk rezulton të jenë parashtruar të dhëna, fakte apo garanci për origjinalitetin e punimeve në referim të gërmës “c”, neni 56, pika 2 e lpp, pasi provueshmëria e këtij kriteri është esenciale duke garantuar autoritetin kontraktor jo vetëm për realizimin e punimeve por për realizimin e tyre sipas standarteve të kërkuara në cilësi dhe volum dhe me çmimin konkurrues të ofertuar.

Referuar pikës ç) Zbatueshmëria e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës në vendin ku kryhet shërbimi apo ku sigurohet furnizimi (zona gjeografike në të cilën është pozicionuar shoqëria, krijojnë kushte lehtësuese për gjetjen e punonjësve, ka një eksperiencë prej 22 vitesh në treg dhe një staf të përbërë prej 54 personash).

Argumentimi i mësipërm jo vetëm nuk qëndron por është në lajthitje sepse: zbatueshmëria e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe me kushtet e punës ka të bëjë me respektimin e detyrimeve ligjore siç janë paga jo më pak se paga minimale në Republikën e Shqipërisë, pagesat e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, respektimi i kushteve sa më normale të punës etj etj.

të punëdhënësit në raport me punëarrësin dhe ska lidhje me vendodhjen e pozicionit të shoqërisë por me respektimin e detyrimeve ligjore të punëdhënësit në raport me punëmarrësin që kosto e produktit apo shërbimit mos të dali më e ulët për shkak të mosrespektimit të detyrimeve ligjore që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës kur kryhet shërbimi apo ku sigurohet furnizimi.

Përsa më sipër argumentuam, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9643 të lpp dhe VKM 914/2014 kërkojmë:

- *Pezullimin e vazhdimin të procedurës së prokurimit derisa ankesa jonë të jetë shqyrtuar plotësisht*
- *Rivlerësimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik Ardeno shpk kualifikimin e saj*
- *Skualifikimin e operatorit ekonomik “Erald” sh.p.k.*
- *Shpalljen fitues të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik Ardeno shpk.*

II.7. Në datën 15.08.2019, nëpërmjet shkresës me nr.1425/1 prot., datë 14.08.2019, me objekt: “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Ardeno” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se arsyeja e skualifikimit « *Operatori ekonomik nuk arriti të permbushë piken 2 të Kapacitetit Teknik pasi nuk ka paraqitur Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore leshuar nga administrata tatimore*”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, pika 2.3. Kapaciteti teknik, pika 2, nga ana e autoritetit kontraktor, pas modifikimit të dokumentave të tenderit, është përcaktuar kriteri: “*Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rast se është prodhues i mobiljeve të drurit duhet të ketë të punësuar për periudhën Janar - Maj 2019, një staf punonjesh minimalisht 30 persona, nga të cilët të pakten 1 (një) punonjes duhet të jete i punësuar si Inxhinier druri i pajisur diplome dhe kontrate pune e vlefshme I perfshire ne listpagese. Për stafin e punonjësve ofertuesi duhet të paraqesë:*

- *Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore leshuar nga administrata tatimore.*
- *Listpagesat për periudhën Janar - Maj 2019”.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik "Ardeno" sh.p.k., konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Vërtetim për pagim detyrimesh me nr. T01172541 datë 20.06.2019 në të cilin citohet se: "tatimpaguesi "Ardeno" sh.p.k. rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datën 20.06.2019 ora 09:03:19".
- Listëpagesat për periudhën Janar –Maj 2019 shoqëruar me Formulart Urdhër Transfertë për secilin muaj

III.1.3. Në nenin 45 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

1. Autoriteti kontraktor skualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike çdo operator ekonomik, nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) korrupsion;

c) mashtrim;

ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;

dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) falsifikim;

ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operator ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga një procedurë, në rastet kur:

a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;

b) është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;

c) është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

ç);

d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

e) është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë kre, ose nuk ka pranuar t'i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.

ë) me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.

3. Me qëllim plotësimit e kushteve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

a) Vërtetim nga dosja gjyqësore, ose një dokument të njëvlefishëm, të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në 1 dhe 2, shkronja “a”, “b” dhe “c”.

b) një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikën 2 shkronjat “d” e “dh”.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.1.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.6. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një ndër parimet kryesore të përzgjedhjes referuar edhe nenit 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar është edhe mosdiskriminimi dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës objekt shqyrtimi, gjë e cila vërtetohet nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, të lëshuar nga organet tatimore të cilat konfirmojnë se shoqëria “Ardeno” sh.p.k. ka një numër të konsiderueshëm punonjësish, duke e tejkalluar disa herë numrin e punonjësve të kërkuar nga autoriteti kontraktor, si edhe duke vërtetuar bindshëm përmbushjen e kriterit për numrin e kërkuar të punonjësve, si edhe nëpërmjet të cilave jepet një informacion i detajuar që përmban të dhëna të mjaftueshme për kërkesat e autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik të vërtetohet se gëzon dhe disponon kapacitetet e duhura në lidhje me stafin dhe personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës, aq më tepër në kushtet kur ky dokumentacion është lëshuar nga organet tatimore, siç

janë formularët E-sig 025/a, si edhe që përmbajnë të dhëna të mjaftueshme për të arritur qëllimin për të cilin autoriteti kontraktor e ka kërkuar këtë kriter, duke siguruar një panoramë të plotë në lidhje me stafin dhe personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës.

Në këtë kuptim, edhe listëpagesat edhe vërtetimet janë dokumenta që i shërbejnë të njëjtit qëllim – vërtetimin që një shoqëri ka të punësuar pranë saj stafin e nevojshëm, ndaj në këtë rast sqarojmë se lidhja e personelit apo stafit të nevojshëm për realizimin e shërbimit të kërkuar me punësimin pranë shoqërisë “Ardeno” sh.p.k. pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi, vërtetohet më së miri me dokumentacionin e paraqitur nga ky operator ekonomik, siç janë listëpagesat për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Në këtë kuptim, referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike në lidhje me numrin e punonjësve, në përputhje dhe në përpjesëtim me natyrën dhe volumin e kontratës objekt prokurimi, kapacitet i cili është vërtetuar se disponohet nga operatori ekonomik “Ardeno” sh.p.k. Konkretisht numri mesatar i punonjësve që disponon kjo shoqëri për periudhën janar – maj 2019 e kalon disa herë kërkesën e parashikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, duke krijuar garanci për realizimin me sukses të kontratës. Nga ana tjetër operatori ekonomik ka paraqitur edhe dokumentin që vërteton se shoqëria “Ardeno” sh.p.k. nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri në datën 20.06.2019.

Sqarojmë se vërtetimi i lëshuar nga organet tatimore ka të njëjtin qëllim për të treguar numrin e punonjësve që një operator ekonomik disponon, fakt ky i vërtetuar më së miri edhe nga listëpagesat e paraqitura.

KPP gjykon se fuqia punëtore e kërkuar për periudhën janar – maj 2019 është përmbushur nga ana e operatorit ekonomik ankimues, kjo provuar me listëpagesat e paraqitura. KPP sqaron se verifikimi i përmbushjes së kriterit për kapacitetet në lidhje me stafin, realizohet në mënyrë alternative edhe me anë të listëpagesave të paraqitura. Sqarojmë se qëllimi i autoritetit kontraktor duhet të jetë verifikimi i kapaciteteve të mjaftueshme për realizimin e kontratës, ndaj përderisa përmbushja e kapaciteteve në rastin konkret fuqia punëtore, provohen më së miri me anë të listëpagesave, atëherë qëllimi final se përse është kërkuar ky kriter është i realizur.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kriteri i numrit mesatar të punonjësve plotësohet dhe tejkalohet nga ankimuesi për gjithë periudhën e specifikuar në dokumentat e tenderit me dokumentacionin e paraqitur.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Ardeno” sh.p.k. me dokumentacionin e paraqitur vërteton se disponon kapacitete në lidhje me personelin.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Ardeno” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Erald” sh.p.k. si ofertë anomalisht e ulët dhe nuk ka arritur të argumentojë këtë ofertë me arsyetimin se “*Operatori ekonomik ka paraqitur ofertë anomalisht të ulët dhe me të drejtë KVO ka kërkuar sqarim oferte. Nga të dhënat e siguruara në Sistemin e Prokurimit Publik në kthimin e përgjigjes për argumentim të ofertës (dokumentat e printuara janë marrë në dritaren kërkesat të faqes së APP-së të kësaj procedure) duke qenë se ne e njohim shumë mirë që në detaj ciklin e*

prodhimit për produktet e ofertuara, argumentimi nëpërmjet dokumentacionit të ofruar nga ky operator e bën të pavlefshëm kualifikimin e ofertës së tij pasi në elementët e ofertës të ofruara nga operator ekonomik rezulojnë në kundërshtim me ligjin[...], Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në Shtojcën 12 të dokumentave të tenderit është përcaktuar:

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Tabela e Veçantë		Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit	
<i>Nr</i>	<i>Emërtimi i artikujve</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasitë e pritshme</i>
1	<i>Etazhier për zyrë e veçantë Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 530 x 35 x 125 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
2	<i>Kasaforta sekrete Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 50 x 50 x 110 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
3	<i>Kolltuqe komplet (3+2+1)</i>	<i>Komplet</i>	<i>1</i>
4	<i>Poltron pritje dyvendësh (kolltuk dyvendësh) Përmasat: Gjerësia: 186 cm, Thellësia: 95 cm, Lartësia: 94 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>5</i>
5	<i>Poltron rrotullues (drejtuesi)</i>	<i>Copë</i>	<i>18</i>
6	<i>Raft për dosje (etazher) Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 90 x 45 x 190 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>6</i>
7	<i>Sirtarierë e lëvizshme me rrota Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 45 x 53 x 60 cm (lartësi se bashku me rrotat)</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>
8	<i>Tavolinë mesi Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 110 x 55 x 45 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
9	<i>Tavolinë pune e thjeshtë në formë L</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>
10	<i>Tavolinë pune rang drejtuesi në formë L</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
11	<i>Varëse rrobash + mbajtëse çadrash (e levizshme)</i>	<i>Copë</i>	<i>10</i>
12	<i>Varëse rrobash e fiksuar në mur Përmasat (gjerësi x lartësi): 70 x 90 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
13	<i>Ndriçues tavoline</i>	<i>Copë</i>	<i>20</i>

Afatet e lëvrimit: Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.

<i>Tabela e Veçantë</i>		<i>Dega e Doganës Tiranë</i>	
<i>Nr</i>	<i>Emërtimi i artikujve</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasitë e pritshme</i>
16	<i>Karrike rrotulluese zyre me bazament dhe krah mbështetës plastik</i>	<i>Copë</i>	<i>49</i>
81	<i>Raftë metalike Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 100 x 60 x 250 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>14</i>

Afatet e lëvrimit: Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.

<i>Tabela e Veçantë</i>		<i>Departamenti i Administratës Publike</i>	
<i>Nr</i>	<i>Emërtimi i artikujve</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasitë e pritshme</i>
16	<i>Karrike rrotulluese zyre me bazament dhe krah mbështetës plastik</i>	<i>Copë</i>	<i>32</i>
36	<i>Sirtarierë e lëvizshme me rrota Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 45 x 53 x 60 cm (lartësi se bashku me rrotat)</i>	<i>Copë</i>	<i>32</i>
54	<i>Tavolinë pune e thjeshtë Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 140 x 80 x 75 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>32</i>
60	<i>Varëse rrobash + mbajtëse çadrash (e levizshme)</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>
81	<i>Raftë metalike Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 100 x 60 x 250 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>12</i>

Afatet e lëvrimit: Brenda 3 muaj nga lidhja e kontrates

<i>Tabela e Veçantë</i>		<i>Autoriteti Rrugor Shqiptar</i>	
<i>Nr</i>	<i>Emërtimi i artikujve</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasitë e pritshme</i>
17	<i>Karrike rrotulluese zyre me bazament dhe krah mbështetës metalik</i>	<i>Copë</i>	<i>100</i>
27	<i>Poltron pritje dyvendësh (kollluk dyvendësh) Përmasat: Gjerësia: 186 cm, Thellësia: 95 cm, Lartësia: 94 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>
28	<i>Poltron pritje njëvendësh (kollluk njëvendësh) Përmasat: Gjerësia: 92 cm, Thellësia: 89 cm, Lartësia: 84 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>
54	<i>Tavolinë pune e thjeshtë Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 140 x 80 x 75 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>100</i>
	<i>Artikuj shtesë me studim tregu (2 artikuj)</i>		
1	<i>Dollap zyre 90x45x210 (gjerësi x thellesi x lartësi)</i>	<i>cope</i>	<i>100</i>
2	<i>Komodina zyre Përmasat (gjerësi x thellesi x lartësi): 45 x 45 x 65 cm</i>	<i>cope</i>	<i>38</i>

Afatet e lëvrimet: Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.

<i>Tabela e Veçantë</i>		<i>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme</i>	
<i>Nr</i>	<i>Emërtimi i artikujve</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasitë e pritshme</i>
1	<i>Tavolina me palosje</i>	<i>Copë</i>	<i>30</i>
2	<i>Rafte për bibliotekën</i>	<i>Copë</i>	<i>17</i>

3	<i>Tavolinë Mbledhjeje ovale</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
4	<i>Poltrona Rrotullues</i>	<i>Copë</i>	<i>34</i>
5	<i>Varëse rrobash metalike (koke prifti)</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>
6	<i>Varëse rrobash plastike (koke prifti)</i>	<i>Copë</i>	<i>15</i>
7	<i>Karrige fikse per sallen e takimeve</i>	<i>Copë</i>	<i>10</i>

Afatet e lëvrim:

Brenda 20 dite nga lidhja e kontrates

<i>Tabela e Veçantë</i>		<i>Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë</i>	
<i>Nr</i>	<i>Emërtimi i artikujve</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasitë e pritshme</i>
<i>1</i>	<i>Dollap për dosje dy kanatësh Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 80 x 45 x 180 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>55</i>
<i>2</i>	<i>Karrige rrotulluese zyre me bazament dhe krah mbështetës metalik</i>	<i>Copë</i>	<i>105</i>
<i>3</i>	<i>Tavolinë pune e thjeshtë Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 140 x 80 x 75 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>105</i>

Afatet e lëvrim: *Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.*

DREJTORIA E PERGJITHSHME E POLICISE SHETIT

<i>Tabela e Veçantë</i>	<i>D.P.P.SH Drejtoria Vendore e Policisë, Shkodër</i>
-------------------------	---

<i>Nr</i>	<i>Emërtimi i artikujve</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasitë e pritshme</i>
1	<i>Banak për recepsion Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 250 x 70 x 110 cm</i>	<i>Copë</i>	3
2	<i>Dollap metalik me sirtar Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 46 x 62 x 133 cm</i>	<i>Copë</i>	90
3	<i>Dollap rrobash për zyra (një kanat) Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 45 x 55 x 200 cm</i>	<i>Copë</i>	270
4	<i>Etazhier për zyrë e veçantë Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 530 x 35 x 125 cm</i>	<i>Copë</i>	4
5	<i>Karrike për salla konferencash</i>	<i>Copë</i>	90
6	<i>Karrike rrotulluese zyre me bazament dhe krah mbështetës plastik</i>	<i>Copë</i>	60
7	<i>Karrike të thjeshta zyre</i>	<i>Copë</i>	150
8	<i>Karrike tip kinema</i>	<i>Copë</i>	30
9	<i>Kasaforta sekrete Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 50 x 50 x 110 cm</i>	<i>Copë</i>	2
10	<i>Kolltuqe komplet (3+2+1)</i>	<i>Komplet</i>	4
11	<i>Krevat tek Përmasat (gjatësi x gjerësi): 190 x 90 cm</i>	<i>Copë</i>	6
12	<i>Poltron pritje njëvendesh (kolltuk njëvendesh) Përmasat: Gjerësia: 92 cm, Thellësia: 89 cm, Lartësia: 84 cm</i>	<i>Copë</i>	7
13	<i>Raft për dosje (etazher) Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 90 x 45 x 190 cm</i>	<i>Copë</i>	80
14	<i>Tavolinë e mesme mbledhjesh Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 255 x 170 x 75 cm</i>	<i>Copë</i>	4
15	<i>Tavolinë ovale për sallë mbledhjesh Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 680 x 235 x 75 cm</i>	<i>Copë</i>	4
16	<i>Tavolinë e vecantë për sallë mbledhjesh Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 200 x 90 x 75 cm</i>	<i>Copë</i>	4

17	<i>Tavolinë e vecantë për sallë mbledhjesh Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 350 x 170 x 75 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>3</i>
18	<i>Tavolinë e vogël mbledhjesh Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 180 x 105 x 75 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>5</i>
19	<i>Tavolinë mesi Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 110 x 55 x 45 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
20	<i>Tavolinë pune e thjeshtë Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 140 x 80 x 75 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>150</i>
21	<i>Tavolinë pune rang drejtuesi Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 180 x 80 x 75 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>6</i>
22	<i>Tavolinë pune rang drejtuesi në formë L</i>	<i>Copë</i>	<i>5</i>
23	<i>Tavolinë televizori Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 80 x 45 x 50 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>7</i>
24	<i>Tavolinë mbledhje Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 500 x 285 x 75 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
25	<i>Varëse rrobash statike metalike përmasa min 34 cm x 34 cm x 180 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>29</i>
26	<i>Perde Roller(screen)</i>	<i>m2</i>	<i>490</i>

Afatet e lëvrimnit:

Brenda 45 dite nga lidhja e kontrates

<i>Tabela e Veçantë</i>		<i>D.P.P.SH Reparti Special "Renea"</i>	
<i>Nr</i>	<i>Emërtimi i artikujve</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasitë e pritshme</i>
<i>1</i>	<i>Banak për reception Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 250 x 70 x 110 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>

2	<i>Dollap metalik me dyer Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 92 x 40 x 195 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>20</i>
3	<i>Dollap rrobash për zyra (dy kanata) Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 90 x 55 x 200 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>20</i>
4	<i>Karrike rrotulluese zyre me bazament dhe krah mbështetës plastik</i>	<i>Copë</i>	<i>14</i>
5	<i>Karrike të thjeshta zyre</i>	<i>Copë</i>	<i>180</i>
6	<i>Kasaforta sekrete Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 50 x 50 x 110 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>5</i>
7	<i>Krevat tek Përmasat (gjatësi x gjerësi): 190 x 90 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>30</i>
8	<i>Raft metalik për arkivë Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 100 x 42 x 250 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>12</i>
9	<i>Raft metalik për dosje (arshivë) Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 90 x 40 x 200 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>12</i>
10	<i>Raft për dosje (etazher) Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 90 x 45 x 190 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>16</i>
11	<i>Tavolinë e mesme mbledhjesh Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 255 x 170 x 75 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
12	<i>Tavolinë ovale për sallë mbledhjesh Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 680 x 235 x 75 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
13	<i>Tavolinë e vecantë për sallë mbledhjesh Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 350 x 170 x 75 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
14	<i>Tavolinë klase Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 180 x 60 x 75 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>30</i>
15	<i>Tavolinë mesi Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 110 x 55 x 45 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>3</i>
16	<i>Tavolinë për dhomë Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 60 x 60 x 75 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>18</i>

17	<i>Tavolinë pune e thjeshtë Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 140 x 80 x 75 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>12</i>
18	<i>Tavolinë pune e thjeshtë në formë L</i>	<i>Copë</i>	<i>15</i>
19	<i>Tavolinë referimi salle Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 80 x 60 x 125 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
20	<i>Tavolinë televizori Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 80 x 45 x 50 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>7</i>
21	<i>Varëse rrobash + mbajtëse çadrash (e levizshme)</i>	<i>Copë</i>	<i>37</i>
22	<i>Varëse rrobash e fiksuar në mur Përmasat (gjerësi x lartësi): 70 x 90 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>75</i>
23	<i>Pasqyrë muri për tualet Përmasa 80 x 60 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>90</i>
24	<i>Tavolinë mbledhje Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 500 x 285 x 75 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
25	<i>Komplet perdesh</i>	<i>Cope</i>	<i>3</i>
26	<i>Perde Roller(screen)</i>	<i>m²</i>	<i>900</i>
27	<i>Karrike auditori</i>	<i>Cope</i>	<i>126</i>
28	<i>Tavoline podiumi</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>
29	<i>Karrike fikse</i>	<i>Cope</i>	<i>2</i>

Afatet e lëvrim:

Brenda 45 dite nga lidhja e kontrates

<i>Tabela e veçantë</i>		<i>Ministria e Brendshme</i>	
<i>Nr</i>	<i>Emërtimi i artikujve</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasitë e pritshme</i>
<i>1</i>	<i>Karrike rrotulluese zyre me bazament dhe krah mbështetës plastik</i>	<i>Copë</i>	<i>40</i>

2	<i>Kasaforta sekrete Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 50 x 50 x 110 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>15</i>
3	<i>Skeleri metalike për arkivë Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 100 x 40 x 230 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>35</i>
4	<i>Tavolina për drejtorët</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>
5	<i>Tavolinë e madhe mbledhjesh</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
6	<i>Karrige për tavolinën e mbledhjeve</i>	<i>Copë</i>	<i>25</i>
7	<i>Karrige për drejtorët</i>	<i>Copë</i>	<i>5</i>
8	<i>Karrige për mbledhje</i>	<i>Copë</i>	<i>15</i>
9	<i>Raft 90*45*200 cm</i>	<i>Copë</i>	<i>25</i>
10	<i>Raft për çelësa</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
11	<i>Grila për dritaret</i>	<i>m2</i>	<i>100</i>

Afatet e lëvrimet: Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.

III.2.2. Gjithashtu në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar dokumenti Aneksi 1, ku janë përcaktuar specifikimet teknike të produkteve/mallrave të kërkuara nga autoriteti kontraktor si më poshtë vijon: *Banak për recepsion, Dollap metalik me dyer, Dollap metalik me sirtar, Dollap për dosje dy kanatësh, Dollap rrobash për zyra (dy kanata), Dollap rrobash për zyra (një kanat), Etazhier për zyrë e veçantë, Karrike për salla konferencash, Karrike rrotulluese zyre me bazament dhe krah mbështetës plastic, Karrike rrotulluese zyre me bazament dhe krah mbështetës metalik, Karrike të thjeshta zyre, Karrige tip kinema, Kasaforta sekrete, Kolltuqe komplet (3+2+1), Krevat tek, Poltron pritje dyvendësh (kolltuk dyvendësh), Poltron pritje njëvendësh (kolltuk njëvendësh), Poltron rrotullues (drejtuesi), Raft metalik për arkivë, Raft metalik për dosje (arshivë), Raft për dosje (etazher), Sirtarierë e lëvizshme me rrota, Skeleri metalike për arkivë, Tavolinë e mesme mbledhjesh, Tavolinë ovale për sallë mbledhjesh, Tavolinë e vecantë për sallë mbledhjesh, Tavolinë e vecantë për sallë mbledhjesh, Tavolinë e vogël mbledhjesh, Tavolinë klase, Tavolinë mesi, Tavolinë për dhomë, Tavolinë pune e thjeshtë, Tavolinë pune e thjeshtë në formë L, Tavolinë pune rang drejtuesi, Tavolinë pune rang drejtuesi, Tavolinë pune rang drejtuesi në formë L, Tavolinë referimi sale, Tavolinë televizori, Varëse rrobash + mbajtëse çadrash (e levizshme), Varëse rrobash e fiksuar në mur, Pasqyrë muri për tualet, Tavolinë mbledhje, Varëse rrobash statike metalike, Ndriçues tavoline, Raft metalike, Dollap zyre, Komodinë, Karrige auditori, Karrige fikse, Tavoline podium, Komplet perde, Perde roller (Screen), tavolina për drejtorët, tavolinë e madhe mbledhjesh, karrige për tavolinën e mbledhjeve, karrige për drejtorët,*

karrige për mbledhje, raft 90*45*200, raft 100 x 23 x 140 (për çelësa), grila për dritaret, Tavolina me palosje, cope 30, Raftë për bibliotekën, copë 17, Tavoline Mbledhjeje ovale, cope 1, Poltrona rrotullues. Sasia cope 34, Varesë rrobash, (koke prifti) metalike, copë 4, Varesë Rrobash, copë 15, Karrige fikse për sallën e takimeve, copë 10.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... ”.

III.2.4. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...]

1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

III.2.5. Në nenin 66, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur.

- Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP-së”.

Sa më sipër referuar, nëse një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, ku thuhet se:

“1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;*
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;*
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;*
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.*

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.2.6. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar e tillë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga LPP, janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P gjykon se nga interpretimi i normës së mësipërme lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e

kontratës dhe kosto që i linden autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj.

III.2.7. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik ankimues “Erald” sh.p.k. si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, oferta ekonomike në vlerën prej 2.347.620 lekë pa TVSH (vlera e ofertës si shumatore e çmimeve për njësi pa TVSH), në zbatim të nenit 66 pika 5 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, rezulton anomalisht e ulët. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar drejt kur gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave i ka kërkuar informacion të detajuar operatorit ekonomik “Erald” në zbatim të nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Rezultun nga verifikimi dhe shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, se në datën 10.07.2019 me shkresë nr. 1277 prot., autoriteti kontraktor ka kërkuar operatorit ekonomik “Erald” sh.p.k. informacion mbi ofertën anomalisht të ulët, sipas të cilës është kërkuar (citojmë) “[...] përpara se të vazhdojmë me procesin e vlerësimit të ofertave, ju kërkojmë të paraqisni me shkrim/ në rrugë elektronike dhe brenda 3 ditëve punë shpjegime për elementë të veçantë të ofertës tuaj [...]”.

III.2.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga autoriteti kontraktor konstatohet se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në datën 12.07.2019, protokolluar me nr. 1277/1 prot., nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara (shoqëruar edhe me kartelën përkatëse të autoritetit kontraktor), shkresa me objekt “Kthim përgjigje” e operatorit ekonomik “Erald” sh.p.k., në të cilën ndërmjet të tjerave citohet si më poshtë vijon:

“[...]”

Firma “Erald” sh.p.k. është një nga firmat prodhuese dhe tregtuese të mobiljeve me një aktivitet prej afro 22 vitesh në fushën e mobiljeve prej druri, hekuri dhe materialeve ndihmëse.

Kompania “Erald” shpk u themelua në vitin 1997 dhe sot është një standart i designit e mobilimit në Shqipëri me një eksperiencë mbi 22 vite.

Ne kemi bërë kërkimin e stilit e kualitetit, misionin tonë kryesor duke u rinovuar vazhdimisht në ofertat tona për të interpretuar sa më mirë stilet e jetës e linjat më modern të designit bashkëkohor. Design është pjesë e kulturës prodhuese e tregtuese të Erald, me objektiv kryesor realizimin e kërkesave të klientit.

Ndërtesa moderne e ekspozitës dhe zyrat funksionale, prej 4200 m² dhe me një sipërfaqe magazinimi prej 18.100 m², janë të vendosura në Autostradën Tiranë – Fushë Krujë km 13. Këtu mund të gjeni gjithçka mbi mobilimin e shtëpive dhe zyrave.

Shoqëria “Erald” sh.p.k. përbëhet nga një staf i kualifikuar dhe i përbërë prej një mesatare prej 54 personash të cilët janë të përkushtuar në punën që ata bëjnë.

Cilësia e produkteve është në përputhje me standartet europiane dhe për dekada me radhë kanë krijuar ambiente të brendshme për tui përshtatur çdo nevojë. Kjo traditë është e mbushur në çdo product dhe detaj dhe merr frymë në copa modern, klasike, elegante dhe unike të mobilieve.

Erald zbulon karakterin e një hapësire duke e shtypur atë me dëshirat e atyre që banojnë në të. Ajo merr frymë në dhomat e gjumit, dhomat e jetesës dhe dhomat e ngrënies, ndërsa i pasuron ato me prekje unike.

Koleksionet tona përfshijnë traditën e markës dhe dizajnit të mobiljeve italiane, njohjen e konvegjencës dhe linjat e sakta në format e pjesëve tona të mobiljeve për të krijuar skenarë prestigjiozë dhe të paharrueshëm. Ne duam të ofrojmë një përzgjedhje autentike të mjediseve të karakterizuara nga poezia me saktësi unike. Koleksionet krijohen për të kënaqur çdo shije dhe formë kërkese, duke ruajtur vazhdimisht një sy për detajet dhe inovacionin.

Erald shpk është një kompani me menaxhim të lartë e të aftë me një staf me përvojë në shërbim të klientit gjithmonë në plan të parë.

Objektivi kryesor plotësimi i dëshirave të klientit.

Arredim me design e kualitet të lartë.

Leader në interpretimin e linjave bashkëkohore te stili.

Shoqëria Erald shpk është e certifikuar nga organizmat ndërkombëtarë në lidhje me cilësinë e produkteve që ajo ofron në treg si dhe produktet që kjo shoqëri ofron janë konform të gjitha standarteve të Komunitetit European përsa i përket cilësisë.

Këtë fakt e tregojnë çertifikatat që janë lëshuar në emër të kësaj kompanie sikurse është ajo ISSO 9001-2008 dhënë shoqërisë lidhur me cilësinë e mallrave dhe shërbimeve që shoqëria ofron.

Teknologjia e përdorur nga ana e kësaj firme në prodhimin e mobiljeve është një teknologji shumë e përparuar dhe e avancuar.

Ambjentet që ajo ka në përdorim për prodhimin e mobiljeve krijojnë kushte lehtësuese për punëtorët dhe prodhimin e mobiljeve.

Ambjentet në të cilat shoqëria ushtron aktivitetin prodhues janë ambiente të ndriçuara mirë duke lejuar shfrytëzimin maksimal të dritës natyrale, gjë e cila ndikon në rendimentin në punë të punëtorëve.

Zona gjeografike në të cilën është pozicionuar shoqëria krijojnë kushte lehtësuese për gjetjen e krahut të lirë të punës me çmime më të lira se në zona të tjera si Tirana, Durrësi etj.

Duke qenë se larmia e produkteve është e ndryshme të jep mundësinë për një shfrytëzim nën maksimum të lëndëve të para pasi edhe prodhimi do të fillojë nga objektet me përmasa të mëdha duke vazhduar deri tek ato me përmasa më të vogla.

Si pasojë edhe mbetjet teknologjike ndoshta mund të shkojnë edhe më pak se 13% që ne kemi parashikuar në preventivë.

Për këto artikuj ka mundësi maksimale edhe për një organizim të përsosur të punës pasi bën një ndarje në mes të reparteve të punës (prerjes, montimit dhe llustrimit).

Firma ka siguruar lëndën e parë nëpërmjet importimit si dhe tregjeve të ndryshme në Shqipëri me çmime tepër konkurruese.

Për të gjitha këto arsye që ne shpjeguem më lart mendojmë se kemi dhënë një ofertë optimal për artikujt që kërkohen.

Më poshtë po japim kosto të artikujve të cilat zënë peshën më të madhe në sasi, të dhënë në ofertën e shoqërisë “Erald” sh.p.k.

Kosto të disa artikujve:

Banak për reception, dollap për dosje 2 kanatësh, dollap rrobash për zyra (dy kanatësh), dollap rrobash për zyra (një kanatësh), etazher për zyrë i veçantë, komplet kolltuqesh, karrige të thjeshta zyre, poltron pritje dyvendësh, poltron pritje njëvendësh, tavolinë mesi, raft për dosje, sirtariere e lëvizshme me rrota, tavolinë e madhe mbledhjesh, tavolinë e mesme mbledhjesh, tavolinë e veçantë për sallë mbledhjesh, tavolinë e vogël mbledhjesh, tavolinë klase, tavolinë kompjuteri, tavolinë mesi, tavolinë pune, tavolinë pune e thjeshtë, tavolinë pune e thjeshtë në formë L, tavolinë pune rang drejtuesi në formë L, tavolinë referimi sale (foltore), tavolinë televizori, varëse rrobash e fiksuar në mur, pasqyrë muri, karrige fikse, etazher për zyrë i veçantë, tavolinë ovale mbledhjesh, dollap zyre, komodinë e lëvizshme, tavolinë për drejtorët, krevat tek.

III.2.9. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga autoriteti kontraktor konstatohet se nga autoriteti kontraktor në datën 17.07.2019, me nr. 1277/2 prot., është protokolluar sërish shkresa e operatorit ekonomik “Erald” sh.p.k. me objekt “Kthim përgjigje”, për argumentimin e ofertës së tij si ofertë anomalisht e ulët, në të cilën konstatohet se është paraqitur si argument e njëjta shkresë, por si shtesë ka bashkëlidhur edhe disa fatura tatimore dhe fletë zhdoganimi.

III.2.10. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “Erald” sh.p.k. nga ku rezulton se ka paraqitur ofertën ekonomike, e cila rezulton se është anomalisht e ulët dhe, sipas informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton se edhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave e ka konstatuar këtë fakt, dhe ka kërkuar që nga operatori ekonomik të paraqitej argumentimi i ofertës në përputhje me përcaktimet e nenit 56 të ligjit për prokurimin publik.

III.2.11. Përpara se të marrë në analizë materialin justifikues/argumentues të operatorit ekonomik “Erald” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson ti referohet edhe praktikës e legjislacionit të BE mbi çështjen. Kështu, në çështjen precedent *Lombardini and Mantovani* (C-285/99 [2001] ECR I-9233), Gjykata Europiane e Drejtësisë (Luksemburg) u shpreh se “*Cilido qoftë legjislacioni, autoritetet kontraktore janë të detyruara të identifikojnë dhe hetojnë Ofertat Anomalisht të Ulëta, pavarësisht nëse ata kanë për qëllim t’i skualifikojnë ato*”. Kjo qasje mbështetet nga fakti se, Komisioni Europian, ndërsa draftonte Direktivën përkatëse, kishte përpara tij Opinionin e Komitetit Ekonomik e Social të Këshillit Europian (CES 515/2001), i cili propozonte se: “*Në rast të një oferte anomalisht të ulët ... duhet të specifikohet se autoritetet kontraktore duhet t’i hetojnë ofertat të cilat duken se janë anomalisht të ulëta. Duhet të përcaktohet qartësisht se ofertat në fjalë do të refuzohen nëse nuk do të paraqitet një justifikim i përshtatshëm*”. Ky parashikim është parë nga këndvështrimi i mbrojtjes së autoriteteve kontraktore nga ofertues që do të fitonin kontrata përmes çmimesh të pambështetura, me rrezik potencial për të rinegociuar fondin limit pak kohë pas lidhjes së kontratës; keqpagimin e punëtorisë apo të nënkontraktorëve,

apo përdorimin e materialeve të cilësisë së ulët. Komisioni European ka deklaruar se ky është një problem i hasur posaçërisht në industrinë e ndërtimit (dokumenti “Parandalimi, Zbulimi dhe Përfundimi i Ofertave Anomalisht të Ulëta në Industrinë Europiane të Ndërtimit” *DG III 5 Qershor 1999*). Një ofertë anomalisht e ulët mund të justifikohet ekonomikisht përmes metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushteve përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar.

III.2.12. Duke u rikthyer në çështjen tonë, nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton se nga ana e operatorit ekonomik “Erald” sh.p.k. me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët është dorëzuar dokumenti *Kthim përgjigje*, i protokolluar në datën 12.07.2019 dhe dokumenti *Kthim përgjigje*, i protokolluar në datën 17.07.2019.

III.2.13. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik “Erald” sh.p.k. në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, përtej titullit të tij, qartësisht rezulton se dokumentacioni i dorëzuar dhe protokolluar në datën 12.07.2019, pranë autoritetit kontraktor, është thjesht një dokument i shkruar në mënyrë narrative ku është bërë një prezantim mbi shoqërinë si edhe ashtu siç citohet edhe në këtë shkresë, është paraqitur një analizë e vetëm disa prej artikujve që sipas operatorit ekonomik zënë peshën më të madhe në sasi. Konstatohet se operatori ekonomik “Erald” sh.p.k. ka paraqitur vetëm një analizë të thjeshtë të disa prej artikujve të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe për asnjë rast nuk ka argumentuar se përse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet, pasi operatori ekonomik, bazuar në legjislacionin e sipërcituar, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës apo provues si: fatura tatimore, fletë zhdoganimi, kontrata furnizimi apo kontrata të mëparshme të lidhura me autoritete të ndryshme, apo ndonjë dokument tjetër, që të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm pse kjo ofertë anomalisht e ulët nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës.

III.2.14. Për më tepër, nga verifikimi i dokumentit të dorëzuar në datë 12.07.2019 të bërë nga Komisioni i Prokurimit Publik, rezulton se, ka edhe mospërputhje të dukshme midis çmimit për njësi të një numri të konsiderueshëm të artikujve të preventivit të ofruar në këtë procedurë prokurimi të krahasuara me çmimet për njësi të identikisht po këtyre zërave, të paraqitur në dokumentacionin që merrte përsipër për argumentimin dhe analizën e çmimeve operatori ekonomik “Erald” sh.p.k..

Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime të cilat nuk janë të mbështetura në fakte e prova që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: *metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar*), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Në lidhje me dokumentin tjetër të dorëzuar për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, të paraqitur dhe protokolluar nga ana e autoritetit kontraktor në datën 17.07.2019 me nr. 1277/2 prot. (dokument në narrativ dhe analizë kosto për disa artikuj, i njëjtë me atë të paraqitur dhe protokolluar pranë autoritetit kontraktor në datën 12.07.2019 me nr. 1277/1 prot., bashkëlidhur të

cilit janë paraqitur shtesë disa fatura tatimore, fletë zhdoganimi), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nuk do të merret në shqyrtim përsa kohë që ky dokument dhe argumentim oferte është paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 56 të ligjit për prokurimin publik i cili qartësisht përcakton se: *“Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës”*.

Sqarojmë se jo pa qëllim nga ana e ligjvënësit janë përcaktuar afate të cilat janë afate procedurale dhe që kanë një rëndësi edhe për procesin e rregullt të zhvillimit të një procedure prokurimi, duke mos krijuar abuzivizëm dhe zvarritje të një procedure prokurimi. Çdo fazë e procedurës së prokurimit ka afatet e saj të përcaktuara qartësisht në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga autoriteti kontraktor dhe nga operatorët ekonomikë të interesuar.

III.2.15. Rrjedhimisht, sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “Erald” sh.p.k. nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në respekt të nenit 56 të LPP-së, ndaj oferta e këtij operatori duhet të ishte skualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik, ndërsa thekson nevojën e kërimit të dokumentacionit shpjegues/argumentues nga një operator ekonomik oferta e të cilit është identifikuar në bazë të formulës ligjore si anomalisht e ulët, përpara sesa autoriteti kontraktor ta skualifikojë atë, nuk mund të mos tërheqë vëmendjen e autoriteteve kontraktore se parimi e kriteri kryesor për përcaktimin e një oferte si fituese nuk është çmimi më i ulët, por vlera më e mirë që mund të përfitohet nga paraja (publike), ose e thënë ndryshe, shërbimi/malli/puna më e mirë duke përmbushur kriteret kualifikuese, që mund të blihet me çmimin më të ulët që i siguron ato.

Për sa mësipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “Ardeno” sh.p.k., për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur”*, me nr. REF-25377-06-05-2019, me objekt: *“Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash”*, me fond limit 81.041.227 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Ardeno” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.

3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Erald” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
 4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Ardeno” sh.p.k.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1351 Protokolli

Datë 02.08.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha